SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A

Pasqyrat Financiare Individuale
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020

(dhe raportin e audituesve të pavarur bashkëngjitur)

Përmbajtje

Raporti i audituesve të pavarur.....i-iii

Pasqyra individuale e pozicionit financiar.....1
Pasqyra individuale e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse....2
Pasqyra individuale e ndryshimeve në kapital.....3
Pasqyra individuale e flukseve monetare.....5
Shënime Shpjeguese të pasqyrave financiare individuale.....5-33
Skedulet Suplementare.....a - b

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri, Kompleksi T.I.D,
Shk. B, Floor 1, 10 000
Tirana, Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a,

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare individuale të Sigal Life Uniqa Group Austria sh.a ("Shoqëria"), të cilat përfshijnë pasqyrën individuale të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2020, pasqyrën individuale të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën individuale të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën individuale të flukseve të parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat individuale financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare individuale bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Shoqërisë më datën 31 dhjetor 2020, dhe performancën financiare dhe flukset e parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale*. Ne jemi të pavarur nga Shoqëria në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesionistë të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Individuale

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare individuale në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare individuale që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Shoqërisë për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Shoqërisë.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Individuale

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare individuale në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare individuale.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare individuale, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë proçedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të entitetit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduari në vijimësi.

- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë proçesit të auditimit.

Raporte të tjera mbi Kërkesat e Kuadrit Rregullator

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për përgatitjen e anekseve shoqëruese suplementare Aktivet në Mbulimin e Detyrimeve të Sigurimit dhe Mjaftueshmërinë e Kapitalit, ("Anekse Shtesë") në përputhje me ligjin "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Bazuar në kërkesat e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare në Shqipëri, ne kemi lexuar anekset suplementare shoqëruese. Këto anekse plotësuese të përgatitura nga drejtimi nuk janë pjesë e këtyre pasqyrave financiare. Informacioni historik financiar, i paraqitur në anekset shtesë të këtyre pasqyrave financiare, është në përputhje me informacionin vjetor financiar shpalosur në pasqyrat financiare të Shoqërisë më 31 dhjetor 2020, përgatitur në përputhje me kërkesat e raportimit financiar për Shoqëritë e Sigurimit në Shqipëri.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
28 prill 2021

Kledian Kodra, FCCA

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA Rruga Sami Frashëri, Kompleksi T.I.D. Hyrja B. Kati 1

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e pozicionit financiar

(të gjitha shumat janë në mijë Lekë, përveç rasteve kur shprehet ndryshe)

	Shënime	31 dhjetor 2020	31 dhjetor 2019
AKTIVET			
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalentë	9	48,707	31,402
Depozita me afat me bankat	10	1,450,002	1,125,854
Investime në letra me vlerë	11	756,519	914,215
Investime në filiale	12	11,232	11,232
Investime ne fonde investimi(kuota)	13	9,208	9,970
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera	14	29,477	33,086
Tatim fitimi i parapaguar	27	-	3,411
Kosto të shtyra të marrjes në sigurim	15	55,912	72,171
Aktive të risigurimit		3,774	4,168
Prona dhe pajisje	16	23,380	17,950
Aktive jo materiale	17	3,631	1,708
Aktive të tjera		757	917
TOTALI I AKTIVEVE		**2,392,599**	**2,226,084**
DETYRIME			
Detyrime për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes total	18	1,566,885	1,513,745
Llogari të pagueshme për risigurimin	19	1,638	1,578
Tatim fitimi per tu paguar	24	3,091	0
Llogari të pagueshme për sigurimin dhe të tjera	20	29,619	28,120
TOTTALI I DETYRIMEVE		**1,601,233**	**1,543,443**
KAPITALI			
Kapitali aksionar	21	370,000	370,000
Rezerva e sigurisë	21	252,175	150,749
Fitime të pashpërndara		127,837	107,381
Rezerve rivleresimi		41,354	54,511
TOTALI I KAPITALIT		**791,366**	**682,641**
TOTALI I KAPITALIT DHE DETYRIMEVE		**2,392,599**	**2,226,084**

Këto pasqyra individuale financiare janë aprovuar nga drejtimi i Shoqërisë më 10 prill 2021 dhe janë firmosur në emër të tyre nga:

Edvin Hoxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA
SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA
Life
SIGAL LIFE
SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SHA
DREJTORIA E PERGJITHSHME
HEAD OFFICE

Edmira Madani
Drejtore e Financave

Shënimet në faqet 5 deri në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e flukseve të mjeteve monetare
(të gjitha shumat jane në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	22	624,968	723,860
Prime të shkruara ceduar risiguruesit		(9,415)	(10,480)
Prime të shkruara neto		**615,553**	**713,380**
Ndryshimi në rezervën e risiguruesit		(394)	(980)
Të ardhura neto nga sigurimi		**615,159**	**712,400**
Të ardhura nga interesi	23	54,086	54,459
Të ardhura të tjera		4,740	5,069
Të ardhura neto		**673,985**	**771,928**
Ndryshimi në rezervat matematikore	18	(49,760)	(128,986)
Humbjet dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	18	(146,797)	(120,023)
Humbjet neto nga sigurim		**(196,557)**	**(249,009)**
Shpenzimet e marrjes në sigurim	24	(242,300)	(284,527)
Shpenzime administrative	25	(83,418)	(95,465)
Shpenzime te tjera operative	26	(13,076)	(13,335)
Fitimi operativ		**138,634**	**129,592**
Te ardhura/Humbja nga kursi i këmbimit neto		4,764	(10,259)
Fitimi para tatimit		**143,398**	**119,333**
Tatim fitimi	27	(21,516)	(17,907)
Fitimi i vitit		**121,882**	**101,426**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		(13,157)	54,511
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		**108,725**	**155,937**

Shënimet në faqet 5 deri në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

SIGAL LIFE UNIQA GROUP AUSTRIA SH.A
Pasqyra individuale e flukseve të mjeteve monetare
(të gjitha shumat jane në mijë Lekë, përveç kur është shprehur ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e sigurisë	Rezerva e rivlerësimit	Fitime të pashpërndara	Totali
Gjendja më 1 janar 2019	**370,000**	**150,749**	**-**	**117,127**	**637,876**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin					
Fitimi i vitit	-	-	-	101,426	101,426
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI)			54,511		**54,511**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**54,511**	**101,426**	**155,937**
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital					
Dividend e paguar	-	-	-	**(111,172)**	**(111,172)**
Totali i transaksioneve me pronarët	**-**	**-**	**-**	**(111,172)**	**(111,172)**
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**370,000**	**150,749**	**54,511**	**107,381**	**682,641**
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin					
Fitimi i vitit	-	-	-	121,882	**121,882**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (OCI)	-	-	(13,157)	-	(13,157)
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin	**-**	**-**	**(13,157)**	**121,882**	**108,725**
Transaksione me pronarët, të rregjistruara direkt në kapital					
Dividend e paguar	-	-	-	-	-
Totali i transaksioneve me pronarët	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Krijimi i rezervave	-	101,426	-	(101,426)	-
Gjendja më 31 dhjetor 2020	**370,000**	**252,175**	**41,354**	**127,837**	**791,366**

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019
Flukse monetare nga veprimtaritë operative			
Fitimi i vitit		**121,882**	**101,426**
Rregullime për:			
Zhvlerësimi	16,17	9,692	1,561
Të ardhurat nga interesi	23	(54,086)	(54,459)
Shpenzime për tatimin mbi fitimin	27	21,516	17,907
Flukset monetare nga veprimtaritë operative përpara ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative		**99,004**	**66,435**
Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet operative:			
Pakësim në kosto të shtyra të marrjes në sigurim		16,258	23,756
(Rritje)/pakësim në llogari të arkëtueshme nga sigurimi e të tjera		3,608	19,143
Pakësim/(rritje) në aktive të risigurimit		394	980
(Rritje) në aktive të tjera		159	56
Ndryshim në detyrimet për humbjen dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes		3,380	22,521
(Rritje)/pakësim në rezervat e tjera		49,760	128,986
(Pakësim)/ rritje në llogari të pagueshme për risigurimie		60	(3,850)
Rritje/(pakësim) në llogari të pagueshme nga sigurimi e të tjera		1,524	(9,283)
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative		**174,147**	**248,744**
Tatim fitimi i paguar	27	(15,014)	(16,781)
Mjete monetare të gjeneruara nga aktiviteti operacional		**159,133**	**231,963**
Flukset monetare nga veprimtaritë investuese			
Shtesa aktive afatgjata jomateriale		(2,224)	-
Shtesa aktive afatgjata materiale	16	(14,821)	(5,022)
(Shtesa)/maturimi i depozitave me afat		(322,990)	(198,013)
Shtesa/ (pakesime) investime në letra me vlerë		144,300	4,242
Interesa të marra		53,907	50,662
Investime financiare të tjera		-	(10,000)
Mjete monetare përdorur në veprimtaritë investuese		**(141,828)**	**(158,131)**
Flukset monetare nga veprimtaritë financuese			
Dividendi i paguar	21	-	(111,172)
Mjete monetare të përdorura në veprimtaritë e financimit		**-**	**(111,172)**
Rritje neto në mjete monetare dhe të tjera ekuivalente		17,305	**(37,340)**
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fillim të vitit		**31,402**	**68,742**
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente në fund të vitit	**9**	**48,707**	**31,402**

Shënimet në faqet 5 deri në 33 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare individuale.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria u themelua në shtator 2004 si një shoqëri sigurimi me kapital aksionar dhe u rregjistrua në Regjistrin Tregtar të Shqipërisë me vendim të Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 32018, datë 3 shtator 2004.

Shoqëria po vepron aktualisht sipas ligjit shqiptar Nr. 52/2014 "Për sigurime dhe risigurime", datë 4 korrik 2014. Aktivitetet kryesore të saj përfshijnë shërbimet e sigurimit të jetës. Shoqëria ka filluar aktivitetin e saj të biznesit në Mars 2005 dhe zyrat kryesore janë të vendosura në Tiranë, Qëndra e Biznesit Sigal,Bulevardi "Zogu I". Më 31 dhjetor 2020 dhe 2019, Shoqëria zotërohet nga Sigal Uniqa Group Austria sh.a ("Shoqëria mëmë"), një subjekt rezident në Shqipëri. Shoqëria kontrolluese përfundimtare është UNIQA Osterrich Versicherungen., Vienna, Austria.

Shoqëria zotëron nje filial në Shqipëri që administron një fond pensioni vullnetar me kontribut të përcaktuar.

Drejtimi i Shoqërisë

Administratori i Shoqërisë është z. Edvin Hoxhaj. Këshilli Mbikqyrës gjatë vitit 2020 dhe deri në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, përbehet nga:

Andreas Brandstetter	Kyetar/Anëtar
Erhard Dr Busek	Nënkryetar
Ëolfgang Kindl	Anëtar
Gerald Mag. Muller	Anëtar
Alexander Breit	Anëtar

2. Bazat e pergatitjes

Pasqyrat financiare individuale janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"), përveç mungesës së konsolidimit të shoqërisë së kontrolluar SH.A.F.P Sigal Life Uniqa Group Austria ("filiali"). Shoqëria kontrolluese përfundimtare Uniqa Insurance A.G. Vienna, Austria përgatisin pasqyra financiare të konsoliduara. Gjitashtu, shoqëria mëmë Sigal Uniqa Group Austria sh.a përgatit pasqyra financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF për Grupin Sigal Uniqa Group Austria sh.a, i cili përfshin Sigal Uniqa Group Austria sh.a, Sigal Life Uniqa Group Austria Sh.a dhe SH.A.F.P Sigal Life Uniqa Group Austria.

Në pasqyrat financiare të konsoliduara, filialet - të cilat janë ato shoqëri në të cilat Grupi, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka një interes prej më shumë se gjysmën e të drejtave të votës ose ka fuqi të ushtrojë kontroll mbi veprimet - janë konsoliduar plotësisht. Pasqyrat financiare të konsoliduara të përgatitura nga Shoqëria memë mund të merren nga http://www.sigal.com.al/. Përdoruesit e këtyre pasqyrave financiare të veçanta duhet t'i lexojnë ato së bashku me pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit më dhe për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2020 me qëllim të marrjes së informacionit të plotë mbi pozicionin financiar, rezultatet e operacioneve dhe ndryshimet në pozicionin financiar të grupit si një e tërë.

Ndryshimet në politikat e rëndësishme kontabël janë të përshkruara në Shënimin 4.

3. Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në Lekë ("Lekë") dhe rrumbullakosur në mijëshen më të afërt, e cila është monedha funksionale e shoqërisë. Monedha funksionale e shoqërisë është monedha në mjedisin primar ekonomik në të cilin ajo operon.

4. Politikat kryesore kontabel

(a) Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare individuale janë përgatitur në bazë të kostos historike.

(b) Transaksionet ne monedhe te huaj

Transaksionet në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të shprehura në monedha të huaja janë konvertuar në monedhën funksionale në kursin e këmbimit në vend në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet jo-monetare që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj përkthehen në monedhën funksionale me e këmbimit në datën në të cilën është përcaktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetarë që maten në bazë të kostos historike në një monedhë të huaj janë konvertuar në kursin e këmbimit të çastit në datën e transaksionit. Diferencat në valutë të huaj që rrjedhin nga përkthimi njihen përgjithësisht në fitim ose humbje.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(c) Filialet dhe konsolidimi

Filialet janë subjekte të kontrolluara nga shoqëria. Kontrolli ekziston kur shoqëria ka fuqinë, drejtpërdrejt ose indirekt, që të qeverisë politikat financiare dhe operative të një njësie ekonomike në mënyrë që të marrë përfitime nga aktivitetet e saj. Në vlerësimin e kontrollit merren parasysh të drejtat potenciale të votimit që aktualisht janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Në përputhje me paragrafin 4 (a) të SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara, Shoqëria plotëson kriteret për përjashtimin nga përgatitja e pasqyrave financiare të konsoliduara.

Shoqëria Mëmë Uniqa Insurance Group A.G, inkorporuar në Ëien, Austri përgatit pasqyra financiare të konsoliduara të disponueshme për përdorim publik që përputhen me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF"). Pronarët nuk kundërshtojnë që Shoqëria të mos paraqesë pasqyra financiare të konsoliduara.

Investimet në filiale në këto pasqyra financiare të veçanta kontabilizohen me kosto. Më shumë detaje mbi investimet në filiale janë dhënë në Shënimin 12.

Investimet testohen për zhvlerësim sa herë që ka tregues se vlera e mbetur kontabël e tij mund të mos jetë e rikuperueshme. Nëse shuma e rikuperueshme e një investimi (vlera më e lartë midis vlerës së drejtë minus koston e shitjes dhe vlerës se tij në përdorim) është më e vogël se vlera kontabël e saj, vlera kontabël neto reduktohet në shumën e rikuperueshme.

Vlera kontabël e një investimi çregjistrohet gjatë nxjerrjes jashtë përdorimit. Diferenca midis vlerës së drejtë të fitimit nga shitjet dhe pjesës së mbetur të vlerës kontabël neto të investimit njihet në fitim ose humbje si fitim ose humbje nga shitja. E njëjta gjë vlen edhe nëse nxjerrja jashtë përdorimit rezulton në kalimin nga filiali në sipërmarrjen e përbashkët ose në pjesëmarrje të matur me kosto.

(d) Klasifikimi i kontratave të sigurimit

Kontratat në të cilat Shoqëria pranon rrezik të rëndësishëm sigurimi klasifikohen si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit është rrezik tjetër përveç rrezikut financiar. Rreziku financiar është rreziku i një ndryshimi të mundshëm në të ardhmen në një ose më shumë nga një normë interesi specifike, çmimi i sigurisë, çmimi i mallrave, kursit të këmbimit, indeksi i çmimeve ose normave, një vlerësim kredie ose indeks kredie ose variabël tjetër, e një variabli jofinanciar që ndryshuesi nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë edhe disa rreziqe financiare.

(e) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit

i) Primet për sigurimin e jetës

Primet e shkruara bruto përbëjnë shumën e detyruar gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt pavarësisht faktit se këto shuma i përkasin plotësisht ose pjesërisht me një periudhë kontabël të mëpasshme. Primet prezantohen bruto nga detyrimet e komisioneve ndaj ndërmjetësve dhe përjashtojnë tatime dhe detyrime doganore të bazuara tek primet. Primet janë fituar që nga data e lidhjes me rrezikun, për periudhën e dëmshpërblimit, në bazë të rrezikut të nënshkruar. Të arkëtueshmet e sigurimeve për të cilat shuma e detyruar vlerësohet të jetë e pa arkëtueshme fshihet. Primet e risigurimit njihen si shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të marrë të risigurimit.

ii) Rezerva për primet e pafituara

Rezerva për Jetën e Debitorit dhe sigurimin e Jetës së Kombinuar është përllogaritur nëpërmjet metodave aktuariale duke marrë në konsideratë vlerën e pamaturuar të policës së sigurimit të rregulluar me koeficentin e rrezikut të vdekshmërisë, për rrezikun e humbjes së jetës si dhe ndërkohë UPR-ja për rrezikun e humbjes se jetës nga aksidentet dhe të shëndetit , Shoqëria ka përdorur metodën pro-rata (metodën 1/365) për të përcaktuar primin e pafituar. Primi i pafituar për sigurimin e mbrojtjes së pagesave ("PPI") është llogaritur bruto nga shpenzimet e marrjes në sigurim. Efekti i kostos së marrjes në sigurim është vlerësuar bazuar në normën e kostos së marrjes në sigurim ndaj primit të shkruar bruto.

iii) Dëmet

Përfitimet e ndodhura për sigurimin e jetës gjatë aktivitetit të përgjithshëm përbëhen nga dëmet e paguara gjatë vitit financiar bashkë me ndryshimin në rezervën për dëmet pezull. Rikuperimet në avancë nga risigurimi paraqiten më vete si aktive. Rikuperimet nga risigurimi dhe rikuperime të tjera vlerësohen në mënyrë të ngjashme me vlerësimin e dëmeve pezull.

4. Politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

iv) Rezervat për dëmet

Rezerva përfaqëson vlerësimin e kostos përfundimtare të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit, dukë përfshirë një llogaritje të kostos së dëmeve të ndodhura por të pa raportuara (IBNR) në atë datë. Rezerva për dëmet pezull krijohet rast pas rasti në bazë të shumës së pritshme. Rezervat për dëmet e ndodhura por të pa raportuara krijohen përmes metodës zinxhir.

v) Dëmet që rrjedhin nga biznesi i sigurimit të jetës.

Demet e biznesit për sigurimin e jetës pasqyrojnë koston e të gjitha dëmeve që dalin gjatë vitit, duke përfshirë shpërblimet e policave të akorduara në pritje të një deklarate bonusi.

vi) Rezerva të tjera matematikore

Rezerva të tjera është përllogaritur mbi bazë police duke përdorur formula aktuariale standarde të bazuara në rezervën e primeve neto. Vlerësimet mbi mortalitetin janë të njëjta me ato për llogaritjen e tarifave te primeve ndërkohë norma e interesit të përdorur nuk e kalon vlerën prej 2.25% dhe Shoqëria llogarit 85 % të normës shtesë të fitimit nëse norma e interesit të fituar rezulton më e lartë sesa interesi teknik i garantuar, duke filluar që nga viti i tretë i sigurimit.

vii) Risigurimi

Kontratat që transferojnë një pjesë kryesore të rrezikut të sigurimit janë kontabilizuar si risigurime. Shumat e rikuperueshme nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit si dhe dëmet e lidhura. Aktivet e risigurimit përfshijnë balancat për t'u arkëtuar nga Shoqëritë e risigurimit për detyrimet nga sigurimet e ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit llogariten në të njëjtën mënyrë si janë llogaritur rezervat e dëmeve pezull, ose përbëjnë pjesën e papaguar nga risiguruesi të dëmeve të paguara nga Shoqëria që lidhen me policën e risiguruar. Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun për të limituar humbjet e mundshme lindur nga ekspozimi në rreziqe të konsiderueshme nga sigurimi i jetës. Risigurimi nuk e çliron siguruesin fillestar nga detyrimet e tij. Primet e ceduara paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në shumën e ngarkuar gjatë vitit. Shumat e rimbursuara janë paraqitur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe në pasqyrën e pozicionit financiar në bazë bruto. Portofoli i produkteve është mbuluar nga një kontratë risigurimi e detyrueshme që mbulon pjesën mbi shumën maksimale të rrezikut për çdo jetë. Çdo përfitim shtesë, ndahet midis shumës së mbajtur dhe tejkalimit në të njëjtin proporcion si shuma e siguruar e jetës. Pjesa e rezervës së risigurimit përcaktohet rast pas rasti në përputhje me marrëveshjet përkatëse.

viii) Kostot e shtyra të marrjes në sigurim

Kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogariten në bazë të policave të sigurimit të jetës me kursim, afateve të rregullta dhe afateve të veçanta. Për policat Jeta me Afat, kostot e shtyra të marrjes në sigurim llogaritet në bazë të komisionit të përcaktuar në baza individuale të policave. Komisioni i paguar për çdo policë është i ndarë nga shuma e shkruar e asaj police. Raporti që rezulton është shumëfishuar me rezervat e primit te pafituar të primeve bruto të shkruara. Si rezultat, kostot e marrjes shtyhen për kohëzgjatjen e policave përkatëse. Për policat e sigurimit me kursim, kostot e shtyra të marrjes në sigurim janë llogaritur në përputhje me Standardet e kostove të shtyra të marrjes në sigurim të Uniqa Group. Shoqëria ka zbatuar qasjen e thjeshtuar të specifikuar në standard. Kështu që për llogaritje është përdorur skedari i thjeshtuar i standardeve i ofruar nga Grupi, së bashku me supozimet e mëposhtme:

- Normat e zbritjes - Normat e liruara nga rreziku që llogariten dhe merren nga Grupi
- Normat e ndalimit - normat e llogaritura në bazë të përvojës së portofolit
- Shkalla e vdekshmërisë - vdekshmëria nga TM-ja e përshtatur për mbajtësin e policës mesatare për secilin vit të nënshkrimit
- Komisioni - komisionet aktuale të brokerimit.

Shpenzimet e marrjes përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, siç janë komisionet e blerjes dhe koston e hartimit të dokumentit të sigurimit, si dhe shpenzimet administrative të ndara lidhur me përpunimin e propozimeve dhe lëshimin e politikave.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(e) Njohja dhe matja e kontratave të sigurimit (vazhdim)

ix) Test i mjaftueshmërisë së përgjegjësisë (LAT)

Në çdo datë raportimi Shoqëria kryen testime për t'u siguruar për mjaftueshmërinë e rezervës së dëmeve. Testimet kryesore të kryera janë "Analiza e Raportit të Dëmeve" dhe "Analiza e Zhvillimit të Provizioneve të Dëmeve". Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht në produktet kryesore të biznesit (sigurim jete dhe jetë e kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet, por edhe mbi dëme që përfshijnë koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize Shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të flukseve monetare dalëse. Shoqëria nuk i skonton këto flukse monetare të parashikuara sepse shumica e dëmeve priten të ekzekutohen brenda vitit.

Përveç kësaj, Shoqëria kryen çdo vit një analizë rakordimi të rezervave të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj rezervë. Nëse identifikohet një mangësi, ajo do të ngarkohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provizion të papërcaktuar të rrezikut nga humbjet që rrjedhin nga Testimi i Mjaftueshmërisë së Detyrimeve. Shoqëria ka përllogaritur LAT për sigurimin afatgjatë të jetës nëpërmjet metodave të jo-jetës dhe për Jetë me Kursim me metodat e jetës në përputhje me SNRF bazuar në vlerësimet aktuale të flukseve të ardhshme të parasë, për të vlerësuar mjaftueshmërinë e rezervës për produktin Jetë me Kursim.

(f) Instrumentet financiare

Shoqëria klasifikon aktivet financiare jo-derivative në hua dhe të arkëtueshme dhe në aktivet e tjera financiare që mbahen në maturim dhe ne dhe në detyrime financiare jo-derivative.

(i) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative – Njohja dhe çregjistrimi

Shoqëria fillimisht njeh llogaritë e arkëtueshme në datën kur ato janë krijuar.

Shoqëria çregjistron një aktiv financiar kur mbarojnë të drejtat kontraktuale rrjedhës së parave nga aktivi financiar, ose ajo transferon të drejtat për të marrë rrjedhë parash kontraktuale në një transaksion në të cilin kryesisht të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë së aktivit financiar janë transferuar ose në të cilat Shoqëria as nuk transferon e as nuk ruan në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë dhe nuk mban kontrollin e aktivit financiar. Çdo interes në aktivet financiare të tilla të çregjistruara që krijohen ose mbahen nga Shoqëria njihen si një aktiv ose detyrim i veçantë

Shoqëria çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale janë përmbushur, ndërprerë apo përfunduar.

(ii) Aktivet dhe detyrimet financiare jo derivative - Matja

Huamarrjet dhe llogaritë e arkëtueshme dhe aktivet financiare të mbajtura deri në maturim fillimisht maten me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që i atribuohet drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, ato maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Detyrimet e tjera financiare jo-derivative fillimisht maten me vlerën e drejtë minus kostot e transaksionit që i atribuohen drejtpërdrejtë. Pas njohjes fillestare, këto detyrime maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(iii) Kompensimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të kompensohen dhe tepricat neto të paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar vetëm kur Shoqëria ka të drejta ligjore për të kompensuar shumat dhe ka qëllim të arkëtoje ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuar kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë përgjatë aktivitetit të Shoqërisë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(f) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Matja me vlerë të drejtë

Vlera e drejtë është shuma për të cilën një aktiv mund të këmbehet ose një detyrim mund të vendoset midis palëve që kanë njohurinë dhe mundësinë të kryejnë transaksione në marrëdhënie normale tregu në datën e matjes. Kur është e mundshme, Shoqëria e mat vlerën e drejtë të një instrumenti duke përdorur çmimet e kuotuara për këtë instrument në tregje aktive. Tregu konsiderohet si aktiv nëse transaksionet për aktivin ose pasivin zhvillohen me frekuencë dhe vëllim të mjaftueshëm për të siguruar informacionin e çmimeve në baza të vazhdueshme. Nëse nuk ka çmim të kuotuar në një treg aktiv, atëherë Shoqëria përdor teknikat e vlerësimit që maksimizojnë përdorimin e inputeve përkatëse të vëzhgueshme dhe minimizojnë përdorimin e inputeve që nuk vëzhgohen. Teknika e zgjedhur e vlerësimit përfshin të gjithë faktorët që pjesëmarrësit e tregut do të merrnin parasysh në çmimet e një transaksioni.

Dëshmia më e mirë e vlerës së drejtë të një instrumenti financiar në njohjen fillestare është zakonisht çmimi i transaksionit - dmth vlera e drejtë e shumës së dhënë ose të marrë. Nëse Shoqëria konstaton se vlera e drejtë në njohjen fillestare ndryshon nga çmimi i transaksionit dhe vlera e drejtë nuk evidentohet as nga një çmim i kuotuar në një treg aktiv për një aktiv ose pasiv identik ose të bazuar në një teknikë vlerësimi që përdor vetëm të dhëna nga tregjet e vëzhguara, atëherë instrumenti financiar fillimisht matet me vlerën e drejtë, të rregulluar për të shtyrë diferencën midis vlerës së drejtë në njohjen fillestare dhe çmimin e transaksionit. Më pas, ky ndryshim njihet në fitim ose humbje në një bazë të përshtatshme gjatë jetës së instrumentit, por jo më vonë se kur vlerësimi mbështetet tërësisht nga të dhënat e tregut të vëzhgueshëm ose transaksioni mbyllet.

(v) Identifikimi dhe zhvlerësimi

Në çdo datë raportimi, Shoqëria vlerëson nëse ka dëshmi objektive që aktivet financiare që nuk mbarten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes janë të zhvlerësuara. Aktivet financiare janë të zhvlerësuara kur dëshmitë objektive tregojnë se një ngjarje humbjeje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit dhe se ngjarja e humbjes ka një ndikim në flukset monetare të ardhshme të aktivit që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Evidenca objektive që një aktiv financiar është zhvlerësuar mund të përfshijë mos-pagesen ose delinkuencen e huamarresit, ristrukturimin e kredisë ose paradhënies nga shoqëria me kushte që, në rrethana të tjera, Shoqëria nuk do ti kishte konsideruar, tregues se një huamarrës ose emëtues do të futet në probleme likuiditeti, zhdukjen tregut aktiv, ose të dhëna të tjera të monitorueshme lidhur me një grup aktivesh sikurse lëvizjet e pafavorshme ne statusin e pagesave te huamarrësit për Shoqërinë, ose kushte ekonomike që janë në korrelacion me mos-pagesen në grup.

Shoqëria merr parasysh dëshmi të zhvlerësimit në të dy nivelet kolektive dhe specifike. Aktivet financiare në nivel kolektiv vlerësohen për zhvlerësim duke grupuar së bashku aktivet me karakteristika të ngjashme të kredisë. Aktivet financiare në nivel specifik identifikohen në bazë të dëshmive objektive të një niveli rreziku që tejkalon nivelin historik të rrezikut të aktiveve të tilla si mungesa, ristrukturimi, kushtet e përkeqësuara ekonomike dhe delikuencës së më shumë se 90 ditëve për një ekspozim të vetëm që nuk ka të ardhura të evidentuara. Kur një ngjarje e mëvonshme shkakton zvogëlimin e humbjes nga zhvlerësimi, humbja nga zhvlerësimi kthehet në fitim ose humbje.

(g) Mjetet monetare dhe ekuivalentet e saj

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e saj përfshijnë paratë të gatshme, depozitat likuide të mbajtura me bankat dhe investime të tjera shumë likuide afatshkurtra me maturim deri në tre muaj nga data e blerjes që i nënshtrohen një rreziku të parëndësishëm të ndryshimeve në vlerën e tyre të drejtë dhe janë përdorur nga Shoqëria në administrimin e angazhimeve të saj afatshkurtra.

Paraja dhe ekuivalentët e saj mbarten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(h) Depozitat me afat

Depozitat me afat janë paraqitur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar në shumën e principalit të mbetur dhe klasifikohen ato me maturim më shumë se tre muaj. Interesi është përllogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe interesat e arkëtueshme pasqyrohen në të arkëtueshmet e tjera.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(i) Investimi në letra me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Shoqëria ne vitin 2020 sipas politikave te Grupit Uniqa i klasifikuar si te vlefshme per shitje si në vitin 2019. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat maten me vlerë e drejtë në mbyllje te periudhës.

Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të tjera

Llogaritë e arkëtueshme përfshijnë llogaritë e arkëtueshme nga të siguruarit dhe njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me koston e amortizuar humbjet më pak nga rënia në vlerë.

(j) Llogaritë e pagueshme nga sigurimet dhe të pagueshmet e tjera

Llogaritë e pagueshme nga sigurimi dhe të tjera njihen fillimisht me vlerën e drejtë minus kostot e transaksioneve të lidhura drejtpërdrejtë me të. Këto detyrime financiare maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(k) Prona dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e pronës dhe pajisjeve maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë si edhe kostot çmontimit e rikthimit të vendit në të cilin ato do të vendosen, në gjendjen e tij fillestare. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe pajisjeve.

(ii) Kostot e mëvonshme

Kostoja e zëvendësimit të një elementi të prona dhe pajisje, i shtohet vlerës së mbartur të këtij elementi nëse është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike që lidhen më këtë element do të shkojnë për Shoqërinë, dhe kostoja e tij mund te matet me besueshmëri. Kostot e mirëmbajtjes ditore te ndërtesave dhe paisjeve njihen ne pasqyrën e te ardhurave ne momentin kur ato ndodhin.

(iii) Zhvleresimi

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e llogaritjes mbi vlerën e mbetur. Aktivet e marra me qira amortizohen për periudhën më të shkurtër midis afatit të qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit. Toka nuk amortizohet. Normat e amortizimit për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si më poshtë:

Ndërtesat	5%
Pajisje zyre	20%
Pajisje kompjuterike	25%
Mjete transporti	20%

(l) Aktive jo-materiale

Aktivet jo-materiale të shoqërisë të ndryshme nga emri i mirë kanë jetë të dobishme të caktuar dhe kryesisht përfshijnë programe kompjuterike të kapitalizuara, patenta, marka tregtare dhe licencat. Licencat e programeve kompjuterike, patentat dhe markat tregtare kapitalizohen në bazë të shpenzimeve të bëra për t'i marrë dhe vënë në përdorim. Kostot e zhvillimit që lidhen direkt me programe të identifikueshme dhe unike që kontrollohen nga Shoqëria regjistrohen si aktive jo-materiale nëse rrjedhja e përfitimeve ekonomike në rritje i tejkalon kostot. Kostot e kapitalizuara përfshijnë shpenzimet e stafit të zhvillimit të programeve kompjuterike dhe një pjesë përkatëse të shpenzimeve të përgjithshme përkatëse. Të gjitha kostot e tjera që lidhen me programe kompjuterike, p.sh. mirëmbajtja e saj, janë shpenzuar kur ndodhin.

Aktivet jo-materiale amortizohen duke përdorur metodën metodën e llogaritjes me vlerën e drejte me norme amortizimi 15%.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(m) Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, drejtimi vlerëson vlerën e rikuperueshme, e cila përcaktohet si vlera më e lartë e një aktivi me vlerën e drejtë minus kostot për shitje dhe vlerën e saj në përdorim. Vlera kontabël është zvogëluar në shumën e rikuperueshme dhe humbja nga zhvlerësimi njihet në fitim ose humbje për vitin. Një humbje nga zhvlerësimi e njohur për një aktiv në vitet e mëparshme kthehet kur është e përshtatshme nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar vlerën e aktivit në përdorim ose vlerën e drejtë minus kostot për shitje.

(n) Kapitali aksionar

Aksionet e zakonshme klasifikohen si kapital. Kostot rritëse që i atribuohen drejtpërdrejt emetimit të aksioneve të reja janë paraqitur në kapital si një zbritje, neto nga tatimi, nga të ardhurat. Çdo tejkalim i vlerës së drejtë të shumës së marrë mbi vlerën nominale të aksioneve të emetuara regjistrohet si pronë e aksioneve në kapitalin neto. Dividendët regjistrohen si pasiv dhe zbriten nga kapitali në periudhën në të cilën ato janë deklaruar dhe miratuar. Çdo dividend i deklaruar pas periudhës raportuese dhe para se pasqyrat financiare të veçanta të jenë autorizuar për t'u deklaruar, paraqiten në shënimin e ngjarjeve pas periudhës raportuese.

(o) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në shënimin 4(d).Të ardhurat nga interesi për aktivet financiare është njohur duke përdorur metodën e interesit efektiv.

(p) Përfitimet e punonjësve

(i) Sigurimet shoqërore të detyrueshme

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit ligjor të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara dhe Shoqeria nuk ka detyrime te tjera.

(ii) Leja vjetore e paguar

Kontributet e Shoqërisë për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse në momentin që ato lindin.

(q) Qiratë

Shoqëria si qiramarrës

Qiratë që nuk i transferohen Shoqërisë në thelb të gjitha rreziqet dhe përfitimet e rastësishme për pronësinë e sendeve me qira janë qira operative. Pagesat e qirasë operative njihen si një shpenzim në pasqyrën e të ardhurave mbi një bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Qiraja e pagueshme e kushtëzuar njihet si një shpenzim në periudhën në të cilën ato janë bërë. Stimujt e marrë nga qiraja njihen si pjesë integrale e shpenzimit total të qirasë, gjatë kohëzgjatjes së qirasë.

Shoqëria si qiramarrës

Shoqëria zbaton një njohje dhe model matjejetë vetme për të gjitha qiradhëniet përveçse qirave afatshkurtra dhe qirave me aktiv me vlerë të vogël. Shoqëria njeh detyrimet e qirasë për të bërë pagesa të qirasë dhe aktive me të drejtë përdorimi që përfaqësojnë të drejtën e përdorimit të aktiveve në fjalë.

Aktiv me të drejtë përdorimi

Shoqëria njeh aktiv me të drejtë përdorimi në datën e fillimit të qirasë. Aktivi me të drejtë përdorimi matet me kosto duke zbritur amortizimin apo humbjet nga zhvlerësimi duke u rregulluar me çdo rivlerësim të detyrimit të qirasë. Kostoja e aktiveve me të drejtë përdorimi përfshin totalin e detyrimeve te qirasë të njohur, kostot direkte fillestare të bëra dhe pagesat e qirasë të bëra në ose para datës së fillimit, duke e pakësuar me çdo stimul të qirasë të marre. Aktivet me të drejtë përdorimi zhvlerësohen në bazë lineare gjatë afatit të qirasë.

Aktivet me të drejtë përdorimi janë paraqitur nëshënimin 19 Aktive të qëndrueshme të trupëzuara dhe aktive me të drejtë përdorimi.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

Detyrimet e qirasë

Në datën e fillimit të qirasë, Shoqëria njeh detyrimet e qirasë, të matura në vlerën aktuale të pagesave të qirasë që do të kryhen gjatë afatit të qirasë. Pagesat e qirasë përfshijnë pagesa fikse (minus çdo stimul të arkëtueshëm), pagesa të ndryshueshme të qirasë që varen nga një indeks ose normë, dhe shumat që pritet të paguhen nën garancitë e vlerës së mbetur. Pagesat e qirasë përfshijnë gjithashtu çmimin e ushtrimit të një opsioni blerjeje në mënyrë të arsyeshme që do të ushtrohet nga Shoqëria dhe pagesa të gjobës për ndërprerjen e qirasë, nëse qiraja reflekton ushtrimin e opsionit për të përfunduar. Pagesat e bëra të qiradhënies operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare gjatë afatit të qirasë. Stimujt e marrë nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e shpenzimit të përgjithshëm të qirasë, gjatë afatit të qirasë. Detyrimet e qirasë paraqiten nën zërin detyrime të tjera.

(r) Provigjionet

Një provigjion njihet kur Shoqëria ka një detyrim aktual ose konstruktiv si rezultat i një ngjarjeje të shkuar dhe është e mundur që një dalje e përfitimeve ekonomike të kërkohet për të shlyer detyrimin. Provigjonet përcaktohen duke zbritur flukset e ardhshme të parave të gatshme në normën para tatimit. Dispozitat pasqyrojnë vlerësimet aktuale të tregut për vlerën kohore të parasë dhe, kur është e përshtatshme, rreziqet specifike për detyrimin.

(s) Tatim fitimi

Tatim fitimi për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave të tjera përmbledhëse. Interesat dhe gjobat që lidhen me tatim fitimin, duke përfshirë trajtimet e pasigurta tatimore, trajtohen sipas *SNK 37 Provigjionet, Detyrimet Kontingjente dhe*

Pasuritë Kontingjente

(i) Tatimi aktual

Tatimi aktual përbëhet nga tatimi i pritshëm i pagueshëm ose i arkëtueshëm mbi të ardhurat ose humbjen e tatueshme për vitin dhe çdo rregullim në tatimin e pagueshëm ose të arkëtueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Vlera e tatimit aktual të pagueshëm ose të arkëtueshme është vlerësimi më i mirë i shumës së tatimit që pritet të paguhet ose të marrë që reflekton pasigurinë në lidhje me tatimet mbi të ardhurat, nëse ka. Ai matet duke përdorur normat e taksave të miratuara ose të miratuara në mënyrë substanciale në datën e raportimit. Aktivet dhe detyrimet tatimore aktuale janë netuar vetëm nëse plotësohen disa kritere.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)

(t) Tatim fitimi ((vazhdim)

(ii) Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor.

Aktivet tatimore të shtyra njihen për humbjet tatimore të papërdorura, kreditë tatimore të papërdorura dhe diferencat e përkohshme të zbritshëm në masën që është e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Aktivet tatimore të shtyra rishikohen në çdo datë të raportimit dhe reduktohen në masën që nuk është më e mundur që përfitimi përkatës tatimor të realizohet; reduktime të tilla kthehen kur zgjidhet probabiliteti i fitimeve të tatueshme në të ardhmen.

Pasuritë tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen në çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që është bërë e mundur që fitimet e tatueshme të ardhshme të jenë në dispozicion kundrejt të cilave ato mund të përdoren. Tatimi i shtyrë matet me normat tatimore që pritet të zbatohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen, duke përdorur normat tatimore të miratuara ose të nxjerra në mënyrë substanciale në datën e raportimit.

Matja e tatimit të shtyrë pasqyron pasojat tatimore që do të pasojnë nga mënyra në të cilën Shoqëria pret në datën e raportimit të rimarrë ose të shlyejë vlerën kontabël të aktiveve dhe detyrimeve të saj. Aktivet dhe detyrimet tatimore të shtyra janë kompensuar vetëm nëse plotësohen disa kritere.

(u) Ndryshimet ne politikat kontabel

Standardet e reja dhe të rishikuara të cilat janë në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janarit 2020

Disa Standarde të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive nga 1 janari 2020 dhe qe janë miratuar nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në rezultatet financiare ose pozicionin e Shoqërisë.

Standarde dhe amendamente të tjera, te cilat janë efektive për herë të parë në vitin 2020 (për një njësi ekonomike me fundin e vitit më 31 dhjetor 2020) dhe mund të jenë të zbatueshme për Shoqërinë janë:

- Kombinimet e Biznesit (Amendament ne SNRF 3)
- Kombinimet Materiale (Amendament ne SNK 1 dhe SNK 8)
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit (Amendamentet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7).
- Amendamentet në Referencat ne kuader koncepti (Standarte te ndryshme).
- Koncesione te lidhura me qira COVID-19 (Amendamente në SNRF 16).

Këto amendamente nuk kanë një ndikim të rëndësishëm në këto Pasqyra Financiare dhe për këtë arsye informacioni shpjegues nuk është dhënë.

Standardet dhe interpretimet e reja ende të pazbatuara

Standarde dhe amendamente të tjera që nuk janë ende efektive dhe nuk janë miratuar herët nga Shoqëria përfshijnë:

- NRF 17 Kontratat e Sigurimit
- Amendamentet në SNRF 17 Kontratat e Sigurimit (Amendamentet në SNRF 17 dhe SNRF 4)
- Referencat në Kuader Konceptuale
- Të ardhurat para përdorimit të synuar (Ndryshimet në SNK 16)
- Kontrata të rënda - Kostoja e përmbushjes së një kontrate (Ndryshimet në SNK 37)
- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së 2018-2020 (Ndryshimet në SNRF 1, SNRF 9, SNRF 16, SNK 41)
- Klasifikimi i detyrimeve si aktuale ose jo-aktuale (ndryshime në SNK 1)

Këto amendamente nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye informacioni shpjeguese nuk është perfshirë.

4. Politika të rëndësishme kontabël (vazhdim)
(u) Ndryshimet ne politikat kontabel (vazhdim)

SNRF 9 Instrumentet financiare

BSNK publikoi versionin përfundimtar të SNRF 9 (Instrumentet Financiarë) në korrik 2014. Kjo zëvendëson SNK 39 (Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja) në tërësi dhe hyn në fuqi në 1 janar 2018. Datat e ndryshme efektive të zbatueshme për SNRF 9 dhe SNRF 17 që duhet të zbatohen në periudhat raportuese që nga 1 janari 2021 do të rezultojnë në rritje të luhatjeve të fitimeve dhe dyfishimin e përpjekjeve të migrimit për periudhën e tranzicionit. Si rezultat i kësaj, BSNK publikoi rregullimet në vitin 2016 në SNRF 4 (Kontratat e Sigurimeve) të cilat lejojnë shoqeritë e sigurimeve të njohin fitime ose humbje të caktuara në të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse (përqasja mbuluese) ose të shtyjnë kohën fillestare të aplikimit për SNRF 9 deri sa SNRF 17 të hyjë në fuqi (qasja e shtyrjes) si pjesë e një procesi tranzicioni.

SNRF 17 Kontratat e sigurimit

SNRF 17 zëvendëson SNRF 4, i cili u paraqit si standard i përkohshëm në vitin 2004. SNRF 4 ka lejuar shoqërite që të vazhdojnë të kontabilizojnë kontratat e sigurimit duke përdorur standardet kombëtare të kontabilitetit, duke rezultuar në një mori qasjesh të ndryshme.

SNRF 17 zgjidh problemet e krahasimit të krijuara nga SNRF 4 duke kërkuar që të gjitha kontratat e sigurimit të kontabilizohen në mënyrë konsistente, duke përfituar nga investitorët dhe shoqëritë e sigurimeve. Obligimet e sigurimit do të llogariten për përdorimin e vlerave aktuale, në vend të kostos historike.

Standarde të tjera

Në datën e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por që nuk janë ende efektive, ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më herët nga Shoqëria.

Drejtimi parashikon që të gjitha Standardet përkatëse do të miratohen në periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të Standardid. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur në shënimet shpjeguese pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

5. Vlerësimet dhe gjykimet kontabël

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon që drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë në zbatimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktiveve, pasiveve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Vlerësimet dhe supozimet e ndërlidhura bazohen në përvojën historike dhe në faktorë të tjerë që besohet të jenë të arsyeshëm sipas rrethanave dhe informacioneve në dispozicion në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare, rezultatet e të cilave formojnë bazën për të bërë gjykime mbi kryerjen e vlerat e aktëtëve dhe pasiveve që nuk janë të dukshme nga burime të tjera. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe supozimet themelore shqyrtohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimi i vlerësimeve kontabël njihet në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet nëse ndryshimi ndikon vetëm atë periudhë ose në periudhën e rishikimit dhe periudhat e ardhshme nëse ndryshimi ndikon në periudhat aktuale dhe në të ardhmen.

Gjykimet e bëra nga drejtimi në zbatimin e SNRF-ve që kanë efekt të rëndësishëm në pasqyrat financiare dhe vlerësimet me një rrezik të konsiderueshëm të përshtatjes materiale në vitin e ardhshëm janë diskutuar më poshtë.

Vlerësimi përfundimtar që lind nga dëmet sipas kontratave të sigurimit

Vlerësimi i detyrimit përfundimtar që rrjedh nga dëmet sipas kontratave të sigurimit është vlerësimi kontabël më i rëndësishëm i Shoqërisë. Në këtë vlerësim duhet të përfshihen disa burime të pasigurta të rëndësishme për vlerësimin e detyrimit përfundimtar të Shoqërisë për këto dëme.

Përcaktimi i detyrimeve sipas kontratave afatgjata të sigurimit varet nga vlerësimet e bëra nga Shoqëria. Vlerësimet bëhen duke marrë parasysh pritshmëritë për numrin e vdekjeve për çdo vit që Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut. Shoqëria i bën këto vlerësime në bazuar tek Tabelat e personalizuara të vdekshmërisë të përshtatura për të reflektëtuar eksperiencën e vetë Shoqërisë. Për kontratat të cilat sigurojnë rrezikun e jetëgjatësisë, krijohet një pritshmëri e kujdesshme por jo e tepruar për përmirësimet në lidhje me vdekshmërinë. Burimi kryesor i pasigurisë është që epidemitë (psh. SIDA, SARS dhe ndryshime të rëndësishme të stilit të jetesës, të tilla si ushqimi, pirja e duhanit, programet e ushtrimit, traumat e pasluftës mund të rezultojnë në pritshmëritë e vdekshmërisë të qënit në mënyrë të rëndësishme më keq se në të shkuarën për grup mosha ndaj të cilave Shoqëria është e ekspozuar në mënyrë të rëndësishme ndaj rrezikut të vdekjes. Megjithatë, përmirësimet e vazhdueshme në kujdesin mjekësor dhe kushtet sociale mund të rezultojnë në përmirësime në jetëgjatësisë përtej atyre të marra parasysh në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e detyrimeve që lindin nga kontratat kur Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të jetëgjatësisë.

Në çdo datë raportimi, Shoqëria kryen analiza për t'u siguruar mbi mjaftueshmërinë e rezervave për kontratat e sigurimit. Testet kryesore lidhen me analizat e raporti të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit mbi linjat kryesore të aktivitetit në mënyrë individuale (sigurimi i jetës për hua dhe sigurimi i kombinuar). Llogaritja kryhet vetëm mbi dëmet si edhe mbi dëmet duke përfshirë shpenzimet e marrjes në sigurim dhe shpenzime të tjera të trajtimit. Gjatë kryerjes së kësaj analize, Shoqëria merr parasysh vlerësimet aktuale të flukseve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i aktualizon këto flukse dalëse sepse pjesa më e madhe e dëmeve pritet të paguhen brenda një viti. Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë për supozimet kryesore të përdorura për vlerësimin e detyrimeve nga dëmet paraqitet në shënimin 6.

Vlërësimi i vlerës së drejtë të letrave me vlerë

Vlera e drejtë e instrumentave financiarë është çmimi që do mund të merej për shitjen e njëaktivi apo do paguhej për transferimin e një detyrimi në një transaksion normal në një treg të rregulluar (ose më i leverdisshëm) në datën e matjes në kushtet e tregut (p.sh., një çmim daljeje) pavarësisht nëse ai çmim është lehtësisht i obsevueshëm ose i vlerësuar nëpërmjet teknikave të vlerësimit. Kur vlera e drejtë e aktiveve financiare dhe detyrimeve financiare që njihet në pasqyrën e pozicionit financiar nuk mund të nxirret nga tregjet aktive, ato përcaktohen duke përdorur një varietet të teknikave të vlerësimit që përfshijnë përdorimin e modeleve të vlerësimit. Inputet në këto modele meren nga tregje të observueshme kur është e mundur, por kur kjo nuk është e mundur, kërkohen vlerësime për përcaktimin e vlerave të drejta. Shoqëria përcakton vlerën e drejtë të investimeve në letra me vlerë duke bazuar në të dhena të publikuara prej agjensive të rating-ung duke përdorur një model vlerësimi i cili merr për bazë cmimin e ofruar të instrumentit nga Bankat e nivelit të dytë.

Parimi i vijimësisë

Drejtimi i ka përgatitur këto pasqyra financiare individuale sipas parimit të vijimësisë. Në krijimin e këtij gjykimi, drejtimi ka kryer një analizë duke konsideruar faktet dhe rrethanat te mundshme si dhe pozicionin financiar të Shoqërisë, qëllimet aktuale, përmirësimet e pritshme në përfitueshmërinë e operacioneve në mënyrë që të konkludojë nëse Shoqëria mund të vazhdojë veprimtarinë sipas parimit të vijimësisë në të ardhmen e afërt, por jo të limituar deri në dymbëdhjetë muaj nga data e periudhës raportuese.

Impakti i Covid 19

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global.
Duke iu përgjigjur kërcënimit që COVID - 19 paraqet për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë ndermorren masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë kufizimet në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj.
Nje pjese e madhe e veprimtarive ekonomike u pezulluan per nje periudhe disamujore.
Shoqëria ka zhvilluar veprimtari gjatë gjithë vitit 2020, në perputhje me planin përkates të vijimësisë së veprimtarisë (orare të kufizuara, punë online, etj.)
Në portofolin e sigurimit të Jetës së Debitorit, gjatë vitit 2020 ka pasur rënie ne te ardhurat nga primet e sigurimit te kontratave te reja, e pasqyruar kjo nje renien e primeve ne nen/portofolin e Single Premium. Kjo për shkak te renies se numrit te huave të reja ne banka (orare te kufizuara, rritje e kerkesave te vleresimit te rrezikut, ulje e treguesve financiare te kredimarresve). Megjithate, duhet theksuar se prej muajit Gusht 2020 primet mujore nga ky nen/portofol kane arritur nivelet e vitit paraardhes dhe me tej ne pergjithesi jane tejkaluar treguesit mujore paraardhes.
Primet e sigurimit per portofolin ekzistues (rinovimet) kane qene pergjithesisht ne te njejtat nivele me vitin paraardhes, ne saje te bashkepunimit te vazhdueshem me bankat perkateser.
Nderkohe, Primet e Fituara ne fund te vitit 2020 qendruan ne nivele normale për shkak të lirimit të rezervave të Single Premium të viteve të mëparshme.

Jeta e Kombinuar
Produkti është i lidhur kryesisht me sigurimet në grup, ku nje pjesë e konsiderueshme e zë portofoli i Institucioneve Shteterore të cilët gjatë vitit 2020 pezulluan thuajse teresisht procedurat e prokurimeve.
Me stabilizimin e situatës rifilluan normalisht procedurat e prokurimeve dhe u rivendosen ne masen me te madhe te ardhurat e meparshme.

Jeta me kursim
Produkti gjate vitit 2020 vijoi me një trend normal me pritshmeritë, me një tendence të lehtë rritjeje të surrendërs për shkak të gjëndjes ekonomike.

Drejtimi i Shoqërise duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e përmendur më lart gjykon që situata financiare e Shoqërisë është e qëndrueshme.
Nisur edhe nga analiza e tremujorit të parë 2021 ku ka një rritje prej 9%, ka pritshmëri që për vitin 2021 primet e shkruara bruto do te kene rritje ne krahasim me vitin 2020.
Shoqëria ka burime të mjaftueshme financiare për të vazhduar aktivitetin dhe për të përmbushur detyrimet si ndaj personelit edhe palëve të treta në të ardhmen.

Drejtimi i Shoqërise duke marrë në konsideratë të gjithë faktorët e përmendur më lart është konfident që Shoqëria ka burime të mjaftueshme për të vazhduar aktivitetin për të ardhmen e parashikueshme.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut aktuarial dhe marrjes në sigurim që rrjedhin nga një gamë e gjerë të produkteve të jetës të ofruara për konsumatorët. Rreziku i sigurimit ka të bëjë me pasigurinë e biznesit të sigurimit. Komponentët më të rëndësishëm të rrezikut të sigurimit janë rreziku i primit dhe rreziku i rezervës. Kjo ka të bëjë me shqetësimin në lidhje me përshtatshmërinë e nivelit të normës së primit të sigurimit dhe mjaftueshmërinë e provizioneve për detyrimet e sigurimit dhe baza e kapitalit.

Rreziku i primit është i pranishëm sapo është lëshuar polica e sigurimit, dhe është rreziku që shpenzimet dhe humbjet e shkaktuara të jenë më të larta se primi i marrë. Rreziku rezervës paraqet rrezikun që niveli absolut i rezervave teknike është i nënvlerësuar ose që pretendimet faktike do të luhaten rreth vlerës statistikore të përllogaritur.

Komponentët e rrezikut të marrjes në sigurim të biznesit të jetës përfshijnë edhe rrezikun biometrik (duke përfshirë vdekshmërinë, jetëgjatësinë, sëmundshmërinë dhe paaftësinë) dhe rrezikun e gabimit. Rreziku i gabimit lidhet me normën më të lartë të paparashikuar ose normën më të ulët të gabimeve të politikave, anullimeve, ndryshimet në statusin e pagesës (ndërprerjen e pagesës së primit) dhe të ndërprerjeve.

6.1 Objektivat e administrimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe prej pasigurisë rreth shumës së dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Shoqëria e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo mbart rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata.

Risigurimi blihet nga Shoqëria për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të patur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në administrimi e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.Kapitali rregullator administrohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Shoqëria është e ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e propabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjonimin, rreziku kryesor që Shoqëria ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se llogaritja. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore. Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

6.2 Strategjia e marrjes në sigurim

Shoqëria ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brënda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur luhatjet e rezultateve të pritshme.

6.3 Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Përgjithesisht, të gjitha produktet e Shoqërisë mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë, ne disa raste mbulimi kufizohet ne mbulim te pjesshem, te humbjeve si pasoje e aksidenteve. Produktet e tjera pervec Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin e ndryshimit të primin nga ana e Shoqërisë. Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Sigurimi i jetës për hua

Kontratat e klasifikuara si "Sigurim i Jetës për hua" janë përgjithësisht polica vjetore të rinovueshme që mbulojnë rrezikun e vdekjes dhe ofrohen për bankat sëbashku me kredinë. Shuma e siguruar zvogëlohet paralelisht me ripagimin e kredisë.

Sigurimi i kombinuar

Sigurimi i kombinuar përbëhet nga polica përmes të cilave shoqëria nënshkruan mbulimet në grup. Kontratat e jetës me afat shlyejnë përfitimet e garantuara në rast vdekjeje të cilat janë të përcaktuara në shuma sigurimi fikse që nuk varen nga shoqëria. Kontratat lëshohen për individë dhe grupe individësh.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

6.3 Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit (vazhdim)

Jeta me kursim

Përfshin sigurimin e jetës dhe një komponent kursimi. Përfitimet nga ky produkt i merr i siguruari nëse ai/ajo jeton në datën e maturimit të policës ose trashëgimtarët në rast të kundërt. Data e maturimit varion nga 5 në 25 vjet. Në rast të daljes nga sigurimi gjatë tre viteve të parë të policës, Shoqëria nuk ka asnjë detyrim ndaj policëmbajtësit. Pas kësaj periudhe, Shoqëria paguan vlerat e përcaktuara nga kushtet në policë. Produkti është afatgjatë dhe me përfitime të garantuara, madhësia e të cilave pritet të rritet në të ardhmen. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila varion nga 1,302 Euro deri ne 100,040 Euro.

Risigurimi dhe përqëndrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të administruar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk heq përgjegjësinë e Shoqërisë si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Shoqëria është e detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Aftësia paguese e risiguruesit analizohet çdo vit duke rishikuar pozicionin e tyre financiar përpara së të nënshkruajnë kontratën. Shoqëria ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin nga humbjet nga kontratat e nënshkurara dhe të minimizojë efektin e humbjes nga sigurimi i jetës, duke nënshkruar kontrata risigurimi me Scor Global.

Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Shoqëria gjykon se gjatë aktivitetit të saj të sigurimit ajo nuk ka akumuluar një ekspozim te rëndësishëm ndaj ngjarjeve katastrofike.

Transaksionet me instrumentet financiare rezultojnë në mbartjen e rrezikut financiar nga ana e Shoqërisë. Rreziku financiar përfshinë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Shoqëria i administron këto rreziqe.

6.4 Interesi Teknik

Norma e interesit teknik në intervalin 0-6%, e ndryshme për çdo monedhë, përdoret për të llogaritur primet e sigurimit. Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për cdo kontratë sigurimi për jetën. Në mënyrë shmangien e rrezikut që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara,norma e interesit në përllogaritjen e rezervave matematike është mbajtur në një nivel jo më lartë lartë se 2.25 %. Në vitin 2020, të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë edhe rezervën matematikore) mbulojnë të ardhurat minimale të garantuara, duke siguruar fitime shtesë mbi interesin teknik. Të ardhurat minimale të garantuara për jetën me kursim jepen me interes të garantuar 2.92%, e cila është pranë normës së përdorur në llogaritje të rezervës matematikore.

Analizat e parametrave aktuarialë të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave për sigurimin e jetës tregojnë që supozimet e bëra janë të besueshme dhe të sakta.

6.5 Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale

Shoqëria llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimt me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anullimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Për të llogaritur rezervën matematikore, shoqëria përdor metodën prospektive neto.

Shoqëria përdor tabelat e mortalitetit të publikuara në Shqipëri dhe të pranuara nga risiguruesi. Interesat teknike të përdorura në llogaritjen e primeve variojnë nga 0% deri në 6% në varësi të datës së lëshimit të policës, llojit të kontratës dhe monedhës përkatëse.Rezervat e portofolit të kombinuar, llogariten me një normë interesi 0% për sigurimin me afat dhe me normën e garantuar të interesit për kontratat me një prim të vetëm.Shoqëria përdor metodën zinxhir për të llogaritur IBNR. Kostot e administrimit të dëmit nuk përfshihen në trekëndshat e përdorur. Ato llogariten veçmas në masën 2% të rezervës për dëmet pezull. Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve bazohet në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

6.6 Rezervat dhe testi i mjaftueshmerisë për supozimet aktuariale (vazhdim)

"Vdekshmëria" është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që shoqëria ka. Të dhënat për rrezikun e "vdekshmërisë" për 2020 janë si më poshtë:

Numri i personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	69,279 njerëz
Mosha e personave të prekshëm nga rreziku i vdekjes	18-72 vjeç
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur në 2020	93 raste
Intervali i numrit të vdekshmërisë të llogaritur në 1,000 njerëz	0.35 deri ne 42

Intervali i moshës dhe numri i vlerësuar i vdekjeve janë të bazuara në informatat nga Instituti i Statistikave. Kështu që rreziku i "vdekshmërisë" i paraqitur në këtë tabelë është brenda pritshmërisë.

Analiza e sensitivitetit

Faktorët kryesor që ndikojnë në fitimin e shoqërisë është niveli i raportit të dëmeve dhe shpenzimeve. Tabela më poshtë paraqet një stimulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Shoqërisë dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

31 dhjetor 2020	Fitimi (Humbja)	Kapitali neto	Fondet e garancisë së detyrueshme
Aktual	121,882	791,367	370,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(8,072)	783,295	370,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(8,342)	783,025	370,000

Rreziqet e lidhura me kontratat e sigurimit të jo-jetës janë komplekse dhe subjekt i një numri variablash që e komplikojnë analizën kualitative të ndjeshmërisë. Shoqëria përdor teknika statistikore dhe aktuariale duke përfshirë tregues të tillë si raporti i humbjes së pritur. Shoqëria e konsideron si të mjaftueshëm detyrimin për dëmet e jo-jetës në sigurim që njihet në pasqyrat e pozicionit financiar për qëllime të veçanta. Megjithatë, përvoja aktuale do të ndryshojë nga rezultati i pritur.

Një përmbledhje e humbjeve nga dëmet dhe raporti i kombinuar për vitin 2020 dhe 2019 është si më poshtë:

	2020	2019
Raporti i dëmeve	27.14%	18.59%
Raporti i shpenzimeve	51.51%	60.91%
Raporti i kombinuar	78.65%	79.49%

Rezultatet e analizës së ndjeshmërisë që tregojnë impaktin mbi fitimin përpara tatimit paraqiten më poshtë. Për këtë lloj sensitiviteti tregohet impakti i një ndryshimi në një faktor të vetëm, duke mbajtur supozimet e tjera të pandryshuara.

	Impakti	2020	2019
Raporti i dëmeve			
5% rritje në raportin e dëmeve	Humbje	(8,314)	(1,266)
5% rënie në raportin e dëmeve	Fitim	8,314	1,266
Raporti i shpenzimit			
5% rritje në raportin e shpenzimeve	Humbje	(15,775)	(19,666)
5% rënie në raportin e shpenzimeve	Fitim	15,775	19,666
Raporti i kombinuar			
5% rritje në raportin e kombinuar	Humbje	(24,089)	(25,668)
5% rënie në raportin e kombinuar	Fitim	24,089	25,668

6.7 Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezikun e sigurimit që të limitojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për cdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Shoqëria i bën rreziqeve specifike, I cili është subjekt në disa rrethana, i limiteve maksimale bazuar në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakort që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Shoqëria mbetet e detyruar ndaj policëmbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

6. Administrimi i rrezikut të sigurimit (vazhdim)

6.7 Rreziku i risigurimit (vazhdim)

Përqendrimi i provigjoneve teknike dhe të dëmeve sipas llojit është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	2020			2019		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Lloji i provigjoneve						
RBNS	126,023	-	126,023	129,753	-	129,753
IBNR	21,152	-	21,152	20,648	-	20,648
Shuma te parashikuara per "Surrender to be paid"	39,882		39,882	33,276		33,276
Provigjoni matematikor	779,291	-	779,291	741,933	-	741,933
Totali	**966,348**	**-**	**966,348**	**925,610**	**-**	**925,610**

Përqëndrimi i primeve të pafitura sipas llojit të kontratës është përmbledhur në tabelën e mëposhtme:

	2020			2019		
	Bruto	Risigurimi	Neto	Bruto	Risigurimi	Neto
Llojet e kontratave						
Sigurim Jeta për hua	580,978	(3,762)	577,216	566,164	(4,160)	562,004
Sigurim Jeta e kombinuar	17,854	(11)	17,842	20,121	(8)	20,113
Sigurim Jeta me kursim	1,706	-	1,706	1,850	-	1,850
Totali	**600,538**	**(3,773)**	**596,764**	**588,135**	**(4,168)**	**583,967**

7. Administrimi i rrezikut financiar

Shoqëria monitoron dhe administron rreziqet financiare që lidhen me veprimtarinë e Shoqërisë nëpërmjet analizës së brendshme të rrezikut që përshkruan ekspozimet sipas shkallës dhe madhësisë së rreziqeve. Këto rreziqe përfshijnë rrezikun e tregut (rrezikun e monedhës, rrezikun e normës së interesit), rrezikun e kredisë dhe rrezikun e likuiditetit. Shoqëria nuk përdor instrumente financiare derivateve për të mbrojtur ekspozimet e këtyre rreziqeve.

i. Rreziku i tregut

Rreziku i tregut mund të përshkruhet si rreziku i ndryshimit në vlerën e drejtë të një instrumenti financiar për shkak të ndryshimeve në normat e interesit, çmimet e kapitalit ose normat e këmbimit valutor. Shoqëria nuk investon në aksione dhe ka instrumente financiare pothuajse ekskluzivisht të shprehura në Euro. Rreziku i normës së interesit është kryesisht me investime të mbajtura deri në maturim që mbahen me norma fikse.

ii. Rreziku valutor

Shoqëria operon në katër monedha të ndryshme: Lekë, Euro, USD dhe CHF. Rreziku i kurseve të këmbimit në portofolet e investimeve është i administruar duke përdorur parimin e përputhjes midis aktiveve/detyrimeve. Shoqëria nuk ka hyrë në ndonjë kontratë për kryerjen e transaksioneve në valutë në të ardhmen ose produkte derivative të këtyre transaksioneve më 31 dhjetor 2020 dhe 2019.

Përputhja aktive/detyrim

Shoqëria i administron aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrim, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë administruar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Shoqërisë. Gjithashtu Shoqëria duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksionar.

Shoqëria vendos objektiva për portofol aktivesh për çdo produkt sigurimi, gjë që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brenda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqëndrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

7. Administrimi i rrezikut financiar (vazhdim)

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Shoqërisë për të arritur objektivat e administrimit të aktiveve/detyrimeve. Shoqëria ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj dhe si rrjedhim është e ekspozuar ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit.

ii. Rreziku valutor (vazhdim)

Shoqëria ka ekspozim minimal ndaj rrezikut të monedhës pasi aktivet financiare të shoqërisë përkojnë kryesisht me të njëjtat valuta si detyrimet kontraktuale të investimit. Si rezultat, rreziku i këmbimit valutor vjen nga aktivet dhe detyrimet të njohura në monedha të tjera.

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	22,229	24,245	2,187	46	**48,707**
Depozita me afat	654,032	717,990	77,980	-	**1,450,002**
Investime në letra me vlerë	756,519	0		-	**756,519**
Investime ne fonde investimi(kuota)	9,208			-	**9,208**
Llogaritë e arketueshme	18,478	10,874	125	-	**29,477**
Aktive të risigurimit	1,377	2,385	12	-	**3,774**
Totali i aktiveve financiare	**1,461,843**	**755,494**	**80,304**	**46**	**2,297,687**
DETYRIMET					
Detyrimet për kontratat e sigurimit	672,191	879,029	15,665	-	**1,566,885**
Llogari të pagueshme për risigurimin		1,638		-	**1,638**
Llogari e tjera të pagueshme	28,325	1,294		-	**29,619**
Totali i detyrimeve financiare	**700,516**	**881,961**	**15,665**	**-**	**1,598,142**
Pozicioni neto në monedhë të huaj	**761,327**	**-126,467**	**64,639**	**46**	**699,545**

Aktivet dhe detyrimet në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë:

	Në Lekë	Në EUR	Në USD	Në CHF	Totali
AKTIVET					
Mjete monetare dhe të tjera ekuivalente	10,556	16,205	4,625	16	**31,402**
Depozita me afat	379,778	675,407	70,669	-	**1,125,854**
Investime në letra me vlerë	914,215	-	-	-	**914,215**
Investime ne fonde investimi(kuota)	9,970	-	-	-	**9,970**
Llogaritë e arketueshme	21,134	11,952	-	-	**33,086**
